



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD U MITROVICU - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.797/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari Individual Naim Mehulli, ne çështjen juridike te paditësit nga Mitrovica te cilën e përfaqësojnë Av dhe jurist , kundër te paditurës të cilin e përfaqëson Av. Publik për shkak të kompensimit të ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar dhe kompensimin ne emër te pagave përcjellëse për në pension, pas mbajtjes se seancës përgatitore publike, ne prezence te autorizuarve te paditësit dhe përfaqësuesit te të paditurës, gjykata me dt. 24.10.2018, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. OBLIGOHET e paditura t'ia paguajë paditësit ne emër te pagesës se 3 pagave për shpërblim jubilar pas pensionimit për periudhën e punës prej 40 vjeçare si mësimdhënës te e paditura, shumen prej **1341 euro**, dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për ne pension, shumen prej **1341 euro**, respektivisht, ne emër te 6 pagave shuma totale prej **2682 euro (dy mije e gjashtëqind e tetëdhjete e dy euro)** të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit ligjor

II. OBLIGOHET e paditura t'ia paguajnë paditësit shpenzimet e procedurës në shumë prej 269 Euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarve te tij, ka ushtruar padi për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te shpërblimit jubilar 3 paga dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për ne pension.

Gjykata, me dt.23.10.2018 , ka caktuar seancë për shqyrtim përgatitor, në të cilën kanë prezantuar të autorizuarit të paditësit Av. _____ dhe jurist _____ dhe përfaqësuesi i të paditurës avokati publik Komunal _____.

Ne këtë seancë, i autorizuari i paditësit av. _____ deklaroi: mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të ushtruar me datë 28.12.2017 pranë kësaj gjykate me propozim që gjykata të njëjtën pas administrimit të provave të aprovoj si të bazuar pasi që konsiderojmë se e njëjta është e bazuar në prova dhe fakte të cilat ia kemi prezantuar kësaj gjykate, e bëj precizimin e kërkesëpadisë ashtu që meqenëse në shkresat e lendes ekziston prova e pasqyrës financiare lidhur me pagat që ka pranuar paditësi, ashtu që kërkoj që gjykata të aprovoj kërkesëpadinë në vlerën e 6 pagave dhe atë 3 paga për shpërblim jubilar dhe 3 paga përcjellëse me rastin e pensionimit ashtu që shuma totale e kërkesëpadisë është 2682 euro pasi që paga e paditësit siç shihet edhe nga pasqyra e llogarisë bankare ka qene 447 euro, ndërsa sa i përket kamatës prej të njëjtës heqim dore. I autorizuari tjetër, jurist _____ ka deklaruar se pajtohet në tërësi me deklaratimet e Av. _____.

Përfaqësuesi i të paditurës _____ deklaroi: e kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadinë mirëpo nuk e kundërshtoj administrimin e provave.

Gjykata, në procedurën e leximit të provave, referuar nenit 7 dhe 8, lexoi: kopja e letërnjoftimit për paditësin, Vërtetimi i lëshuar nga shkolla fillore dhe e mesme e ulët "Ismail Qemajli" Mitrovice të datës 04.12.2017, Njoftimi lëshuar nga Komuna e Mitrovicës të datës 20.10.2017, Kartela për lajmërim të pensionistit, Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale mbi njohjen e të drejtës së pensionit të datës 07.09.2016, Vendimi për pushimin e marrëdhënies së punës lëshuar nga Komuna e Mitrovicës të datës 27.04.2015, Vërtetimi i lëshuar nga Sindikata e bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës të datës 11.12.2017, Kartela e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit për paditësin, Pasqyra e llogarisë bankare të datës 07.12.2017 dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Nuk është kontestues fakti që paditësi _____ ka qene punëtor të e paditura _____ për _____ dhe ka punuar si mësimdhënës në SHFMU " Ismail Qemajli " në Mitrovice.

Nuk është kontestues fakti se paditësi ka punuar të e paditura pandërprerë që nga data 01.09.1975 gjere me datën 01.05.2015 , respektivisht, periudha kohore e punës pandërprerë e paditësit të e paditura ka qene 40 vite.

Nuk është kontestues fakti se me vendimin MPMS-Departamenti i Pensioneve paditësi është shfrytëzues i pensionit kontributpagues nga data 04.05.2016.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto që paditësi e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 447 euro.

Gjykata për vendosje sipas pikës 1 të dispozitivit sa i përket pagesës së tri pagave në emër të shpërblimit jubilar iu referua nenit 36 par 9 nenpar 9.3 dhe 9.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të Kosovës me të cilën parashihet se "punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit ti njihet e drejta në shpërblim jubilar në vlerë-lartësia të tri pagave mujore të tij" ndërsa gjykata me rastin e vendosjes në emër të kompensimit për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension u bazua në nenin 36 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të Kosovës me të cilën parashihet e drejta e punëmarrësit-paditësit në pagesën përcjellëse të tri pagave mujore që i ka marrë në tre muajt fundit.

Bazuar në nenin 36 par.9.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të Kosovës është detyrim i punëdhënësit të fundit këtu të paditurës që ti paguaj kompensimin për dy kategori të lartcekura.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se edhe përkundër kërkesës Nr. 17-130/162-0042301 që paditësi me datë 04.12.2017 ka parashtruar të paditurës për pagesën e këtyre kompensimeve e njëjta nuk ka vepruar sipas obligimit nga neni 36 par 9 nenpar.9.5 i Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të Kosovës, gjegjësisht në afat prej një muaji nga data e parashtrimit të kërkesës nga ana e paditësit nuk i ka bërë kompensimin e këtyre pagave me arsyen se nuk ka baze të mjaftueshme ligjore për pagesën e tri pagave përcjellëse pas pensionimit.

Gjykata kur ka vendosur sipas pikës 1 të dispozitivit sa i përket pagesës së tri pagave në emër të shpërblimit jubilar, përveç Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të Kosovës, iu referua edhe nenit 52 par 1 nenpar 1.3 të Marrëveshjes së përgjithshme kolektive të datës 18.03.2014, me të cilën parashihet se "punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit ti njihet e drejta në shpërblim jubilar në vlerë-lartësia të tri pagave mujore të tij" ndërsa gjykata me rastin e vendosjes në emër të kompensimit për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension u bazua në nenin 53 të marrëveshjes kolektive me të cilën parashihet e drejta e punëmarrësit paditësit në pagesën përcjellëse të tri pagave mujore që i ka marrë në tre muajt fundit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesve të autorizuar të paditësit, për 1 seancë të mbajtur, në shumën prej 135 euro, 104 euro në emër të përpilimit të padis dhe 30 euro në emër të taksës për padi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-se.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.797/2017 data 24.10.2018



UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet të brejta në ankese, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.